

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8375
E shtunë, 29 gusht 2026
Çmimi 0. 50 €

Hektor Beqiri: Më 16 shtator, Haga do të jehojë fuqishëm nga zëri i mërgatës shqiptare

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-ja DHE BE-ja NË KUVEND, PDK-ja DHE ALEANCA AKUZOJNË LV-në PËR BLLOKADË: KOSOVA PO ZHYTET NË KRIZË

FAQE 4-5



Deputetët e PDK-së dhe Aleancës janë kthyer sërish të premtën në sallën e Kuvendit të Kosovës, ku kanë kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, e cila, sipas


tyre, po refuzohet të thirret nga Lëvizja Vetëvendosje. Aktivitetin e PDK-së dhe Aleancës në Kuvend e kanë përcjellë nga afër edhe zyrtarë të Ambasadës së

ShBA-së dhe të BE-së. Dy partitë opozitare po bëjnë presion, brenda dhe jashtë Kuvendit, në mënyrë që Kosova të bëhet me institucione të reja

A BARTIN PËRGJEGJËSI PENALE QEVERTITARËT NË DETYRË PËR MBAJTJEN E DY FUNKSIONEVE? F. 3



KONJUFCA SHPALLET I PAFAJSHËM PËR HEDHJEN E GAZIT LOTSJELLËS NË KUVEND F. 6



ATK-ja DHE POSTA E KOSOVËS DISKUTOJNË THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT DHE DIGJITALIZIMIN E SHËRMBIMEVE F. 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË



DONJETA SADIKU E ARTË NË LOJËRAT MESDHETARE F. 11

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KRYEQYTETI I KOSOVËS I SHPALL TË PAFAJSHËM THAÇIN, VESELIN, SELIMIN DHE KRASNIQIN F. 3

KEARNS KRITIKON SERBINË PËR NDERIMET NDAJ RATKO MLLADIQIT: AMBICIET E TIJ NUK VDIQËN ME TË F. 2

KADETËT E FSK-së PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË AKADEMINË USHTARAKE NË GJERMANI F. 7

EKONOMI



QUMËSHTORET KËRKOJNË RIKTHIMIN E PRODHIMIT, PARALAJMËROJNË NDERPRERJEN E GRUMBULLIMIT NGA 1 SHTATORI F. 8

SPORT

KEARNS KRITIKON SERBINË PËR NDERIMET NDAJ RATKO MLLADIQIT: AMBICIET E TIJ NUK VDIQËN ME TË



LONDËR, 28 GUSHT - Deputetja britanike, Alicia Kearns, ka reaguar pas raportimeve se Ratko Mlladiqi, ish-komandanti i forcave serbe të Bosnjës, i dënua për gjenocid nga drejtësia ndërkombëtare, do të varroset në Serbi me nderime të larta shtetërore.

Kearns, përmes një postimi në rrjetin social "X", ka kritikuar presidentin serb Aleksandër Vuçiq dhe Qeverinë e Serbisë për qëndrimin ndaj gjenocidit në Srebrenicë. "Vuçiqi dhe qeveria serbe e mohojnë gjenocidin në Srebrenicë. Tani

ata do ta varrosin njeriun që dha urdhrat, Ratko Mlladiqin, me nderime të plota. Kjo është një rrëfim", ka shkruar Kearns.

Ajo ka theksuar se vdekja e Mlladiqit nuk nënkupton edhe zhdukjen e ideve që ai përfaqësonte. "Mlladiqi ka vdekur, por miliona boshnjakë vazhdojnë të jetojnë. Çdo jetë e jetuar është një fitore kundër tij dhe ambicieve të tij gjenocidale", ka shkruar deputetja britanike.

Kearns ka paralajmëruar gjithashtu se mohimi i gjenocidit në Srebrenicë kontribuon në

mbajtjen gjallë të këtyre ideve. "Mos mendoni se ato ambicie vdiqën me të. Ato mbahen gjallë nga ata që e mohojnë gjenocidin", ka shtuar ajo.

Ratko Mlladiqi vdiq më 27 gusht në Hagë, ndërsa ishte duke vuajtur dënimin e përjetshëm. Ai ishte dënua nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, përfshirë përgjegjësinë për masakrën e Srebrenicës në vitin 1995, ku u vranë më shumë se 8 mijë burra dhe djem boshnjakë.

TRUMPI HEDH POSHTË DRUAJTJET PËR NDONJË SULM RUS NDAJ NATO-s, PAS VIZITËS SË SHEFIT TË CIA-s NË MOSKË

UASHINGTON, 28 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se nuk beson se Moska do ta sulmojë ndonjë vend anëtar të NATO-s, pavarësisht rritjes së shqetësimeve se presidenti rus, Vladimir Putin, mund të urdhërojë sulm ndaj një vendi baltik ose ndonjë vendi tjetër anëtar, për ta vënë në sprovë vendosmërinë e aleancës perëndimore.

Trumpi u ka thënë gazetarëve të enjten vonë në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë se kishte zhvilluar "biseda të mira" me Putinin dhe se "ai nuk do të sulmojë territorin e NATO-s". Trumpi nuk ka treguar se kur janë zhvilluar këto biseda. "Unë nuk jam fare i shqetësuar... nuk ka asnjë telash", e ka cituar më herët Trumpin mediumi Axios, kur ai është pyetur nëse ekziston mundësia që Rusia ta provokojë ndonjë shtet të NATO-s.

Këto deklarata janë bërë në të njëjtën kohë kur Kremli i ka hedhur poshtë si "rrëfime frikësuese" raportet në mediat amerikane se Moska mund ta sulmojë NATO-n, si dhe pas një vizite të papritur të drejtorit të CIA-s në Moskë.

Garancitë e Nenit 5 të NATO-s

Siguria e Evropës Perëndimore ka qenë prej kohësh e lidhur me klauzolën e mbrojtjes së ndërsjellë të NATO-s, Neni 5, i

cili përcakton se një sulm ndaj një vendi anëtar konsiderohet sulm ndaj të gjithë anëtarëve. Shumë liderë dhe zyrtarë perëndimorë kanë shprehur shqetësime lidhur me përkushtimin e Trumpit ndaj aleancës ushtarake. Në disa raste, Trumpi ka vënë në pikëpyetje nëse ShBA-ja do të reagojë ndaj një sulmi kundër një vendi anëtar, ndërsa në raste të tjera ka rikonfirmuar mbështetjen për NATO-n.

Një letër e parë nga "REL"-i zbulon shqetësimin në rritje për agresionin rus në shtetet baltike. Në letër flitet për një "mjedis të përkeqësuar të sigurisë", në kushtet e një "shpeshitimi të shkeljeve të hapësirës ajrore dhe inkursioneve me dronë". Letra i është dërguar presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe është nënshkruar nga tre komisionarët evropianë nga vendet baltike, Kaja Kallas, Andrius Kubilius dhe Valdis Dombrovskis, si dhe nga komisionarët e Polonisë dhe Finlandës. Letra, e datës 30 korrik, ka qenë njëra nga një sërë alarimesh lidhur me agresionin rus gjatë verës, të cilat kanë kulmuar me vizitën e papritur të drejtorit të CIA-s, John Ratcliffe, në Moskë më 25 gusht. Ratcliffe ka fluturuar drejt Moskës për t'i bërë thirrje Kremlini të mos e përshkallëzojë gjendjen me aleatët e ShBA-së, veçanërisht me Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë.



"Çdo gjashtë muaj"

"Axios" ka cituar Trumpin duke mohuar se Ratcliffe u ka përcjellë rusëve një paralajmërim të tillë. "Ratcliffe takohet me homologun e tij rus një herë në gjashtë muaj ose një herë në vit. Ata kanë marrëdhënie shumë të mira. Nuk kishte asnjë mesazh dhe nuk kishte asgjë të pazakontë", ka thënë Trumpi.

Por, kur gazetarët e kanë pyetur më vonë për këtë çështje në Zyrën Ovale, Trumpi është dukur se është tërhequr disi nga deklarata e tij e mëparshme, duke thënë: "Nuk dua të komentoj për këtë, por ata nuk do ta sulmojnë (NATO-n)".

Gazeta "New York Times", duke cituar zyrtarë dhe ish-zyrtarë, ka raportuar se Ratcliffe i ka dhënë homologut të tij një vlerësim të zymtë për gjendjen e luftës së Rusisë kundër Ukrainës dhe i ka bërë thirrje Kremlini të arrijë një marrëveshje para se gjendja

ushtarake dhe ekonomike e Rusisë të përkeqësohet më tej. Gazeta "Wall Street Journal" ka raportuar më herët, duke cituar burime të inteligjencës amerikane, se Rusia mund ta vinte në sprovë vendosmërinë e NATO-s përmes një inkursioni të kufizuar, madje që në vjeshtën e këtij viti.

Diplomatë baltikë, të cilët kanë folur për "REL"-in në kushte anonimiteti, kanë konfirmuar se gjatë verës ka pasur informacione të tjera të inteligjencës për operacione ruse nën flamur të rremë, por nuk ka pasur tregues për ndonjë sulm konvencional. Ata gjithashtu kanë theksuar se operacione të tilla mund të mos kufizohen vetëm në shtetet baltike. Ky shqetësim është përforcuar nga rastet e fundit të përfshirjes së dyshuar ose të supozuar ruse në përpjekje për vrasje, zjarre dhe inkursione me dronë në disa vende të NATO-s, përfshirë Gjermaninë, Poloninë

dhe Sllovakinë.

Trysnia ndaj vendeve anëtare të NATO-s

Ndërkohë, një zyrtar i lartë i Pentagonit u ka bërë thirrje të enjten aleatëve të NATO-s të shpjegojnë se si po u përgjigjen kërkesave të ShBA-së për të marrë më shumë përgjegjësi për mbrojtjen e Evropës, ndërkohë që Uashingtoni po e rishikon nivelin e pranisë së trupave amerikane në këtë kontinent. Administrata e Trumpit i ka shqetësuar aleatët se SHBA-ja mund ta kufizojë praninë e saj ushtarake në Evropë, pas një rishikimi gjashtëmuajor që ka nisur në korrik. "Qasja me të cilën vijmë është, padyshim, ajo e konsultimit dhe angazhimit. Ne duam të dëgjojmë nga aleatët tanë", ka thënë zëvendëssekretari amerikan i Mbrojtjes, Elbridge Colby, gjatë një vizite në selinë e NATO-s në Bruksel, ku ka zhvilluar bisedime.

Uashingtoni u ka dërguar vendeve evropiane një pyetësor, duke u kërkuar të shpjegojnë përpjekjet e tyre për të marrë rol udhëheqës në mbrojtjen e kontinentit. "Ne, në fakt, po zhvillojmë një bisedë shumë praktike për mënyrën se si do të ecim përpara së bashku në një botë ku Evropa, e cila është padyshim një kontinent shumë i pasur, mund dhe po merr përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e vet konvencionale", ka thënë Colby.

Zvicra synon të ndërtojë një batalion ushtarak dronësh deri në vitin 2028

BERN, 28 GUSHT - Zvicra ka njoftuar synimin për të krijuar një batalion ushtarak dronësh deri në vitin 2028, në kuadër të një tendence të riarmatimit në të gjithë Evropën. "Nga viti 2028, ushtria do të vendosë batalionin e saj të dronëve për

zbulim, operacione dhe mbrojtje", ka bërë me dije Ministria e Mbrojtjes në një deklaratë. Batalioni do të mbështetet nga një program i specializuar rekrutimi dhe trajnimit. Ministria ka përshkruar gjithashtu planet

për krijimin e një qendre civilo-ushtarake për dronë dhe robotikë, e përbërë nga një qendër teknologjike dhe një komandë ushtarake. "Zgjidhjet e reja do të zhvillohen, testohen dhe do të bëhen shpejt të përdorshme

për përdorim ushtarak", ka deklaruar ministria.

Ministria e Mbrojtjes ka thënë se dronët, mbrojtja kundër dronëve dhe robotika tashmë janë një "prioritet strategjik" për vendin alpin pa dalje në det.



Hektor Beqiri: Më 16 shtator, Haga do të jehojë fuqishëm nga zëri i mërgatës shqiptare

HAGË, 28 GUSHT - Veprimtari dhe binizimeni i njohur nga diaspora, Hektor Beqiri, i cili u ka qëndruar pranë liderëve të UÇK-së në Hagë që nga dita e parë kur ata kanë lëshuare Kosovën, ka paralajmëruar një organizim të madh të mërgatës shqiptare më 16

shtator, në ditën e shpalljes së aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Beqiri ka bërë me dije se mijëra shqiptarë priten të mbledhen pranë gjykatës në Hagë, për të shprehur mbështetjen e tyre për

çlirimtarët. “Më 16 shtator, Haga nuk do të dëgjojë vetëm një vendim. Do të dëgjojë zërin e fuqishëm të mërgatës shqiptare”, ka deklaruar Beqiri. Ai ka theksuar se pas gjashtë vitesh përballjeje me procesin gjyqësor, krerët e UÇK-së do ta kenë pranë mbështetjen e

mijëra bashkatdhetarëve, me mesazhin: “Nuk jeni vetëm! Kosova dhe të gjithë shqiptarët janë me ju!”. Hektor Beqiri, ka theksuar se detaje të tjera rreth organizimit të 16 shtatorit në Hagë do të bëhen të ditura në ditët në vijim.



SI NDIKON REFERENDUMI NË ISLANDË NË RRUGËN E SHQIPËRISË DHE MALIT TË ZI DREJT BE-së?

PRISHTINË, 28 GUSHT - Nëse islandezët votojnë pro rifillimit të bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) këtë fundjavë, atëherë me të do të ndryshojë edhe renditja e vendeve lidere në procesin e anëtarësimit në bllok. Islanda veçohet si një vend shumë specifik, pasi tashmë është në masë të madhe e integruar në BE dhe është pjesë e shumë politikave evropiane. Ajo është anëtare e Zonës Ekonomike Evropiane dhe e Zonës Shengen. Ndryshe nga vendet e tjera tradicionale candidate, Islanda nuk ka nevojë të ndryshojë rrënjësisht sistemin juridik, gjyqësor apo politik, për t'i përmbushur kërkesat bazë të BE-së. Kjo do të thotë se një rikthim i Islandës në procesin e anëtarësimit do të ndikonte drejtpërdrejt te dy vendet që tani shihen si lidere në procesin integruar: Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilat mbajnë vendin e parë, përkatësisht të dytë, në listë. Këto dy shtete e shohin referendumin si një tjetër shenjë se sa tërheqës është Bashkimi Evropian për vendet që nuk janë pjesë e tij. Bashkëbiseduesit e “Radios Evropa e Lirë (REL)” nga Tirana dhe Podgorica konsiderojnë se mbajtja e këtij referendumi dëshmon se projekti evropian vazhdon të jetë tërheqës dhe është strategjikisht i rëndësishëm për vendet e kontinentit. Qytetarët islandezë do të dalin më 29 gusht në referendum për t'u shprehur nëse duan që vendi t'i rifillojë negociatat për anëtarësim në bllokun me 27 vende anëtare. Rezultati i referendomit është tejet i pasigurt. Sondazhet më të fundit tregojnë se votuesit islandezë janë jashtëzakonisht të ndarë, pothuajse në tëh të brishtë, ndërsa rifillimi i bisedimeve mbështetet nga një shumicë e ngushtë dhe në rënie. Votimi ka karakter këshillimor dhe lidhet ekskluzivisht me rihapjen e negociatave, dhe jo me vendimin përfundimtar për anëtarësimin në BE.

Çfarë kanë thënë në Tiranë dhe Podgoricë?

Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilat janë thellë në procesin e

negociatave për anëtarësim, e shohin pozitivisht referendumin në shtetin ishullor nordik mes Evropës dhe Atlantikut të Veriut. Nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) e Shqipërisë kanë thënë se referendumi konsiderohet shprehje sovraane dhe demokratike e vullnetit të qytetarëve islandezë për të përcaktuar marrëdhënien e vendit të tyre me Bashkimin Evropian. “Çdo vend evropian ka të drejtën të zgjedhë rrugën e vet drejt integritetit evropian. Nga perspektiva jonë, fakti që një vend me nivel të lartë zhvillimi, institucione të konsoliduara dhe integritet të thellë ekonomik me Evropën po i rikthehet kësaj çështjeje dhe po shqyrton sërish afrimin e mëtejshëm me Bashkimin Evropian dëshmon se projekti evropian vazhdon të mbetet tërheqës, i besueshëm dhe strategjik për vendet e kontinentit”, kanë thënë për “REL”-in nga MPJ-ja shqiptare. Maida Gorçeviq, ministre e Çështjeve Evropiane e Malit të Zi, ka thënë se Podgorica mirëpret çdo hap që e bën Evropën më të bashkuar dhe më të fuqishme dhe se referendumi në Islandë po ndiqet me vëmendje, duke respektuar vendimin e qytetarëve islandezë. “Është në interes të Malit të Zi që Bashkimi Evropian të jetë i fuqishëm dhe i qëndrueshëm, dhe besoj se politika e zgjerimit kontribuon pikërisht në këtë. Prandaj, ne gëzojemi për çdo hap të ri drejt zgjerimit dhe mbështetjes aspiratave evropiane të shteteve që me Malin e Zi ndajnë angazhimin për arritjen e standardeve dhe vlerave evropiane dhe përkatësinë në familjen evropiane”, ka deklaruar Gorçeviq. Mali i Zi vazhdon të jetë i pari në rrugën drejt BE-së, me 18 nga gjithsej 33 kapituj negociues të mbyllur. Islanda, e cila i ka filluar negociatat për anëtarësim në vitin 2010 dhe i ka ndërprerë ato në vitin 2013, ka 11 kapituj negociues të mbyllur përkohësisht. “Malit i Zi është sot shteti kandidat më i avancuar dhe është i vendosur ta përfundojë pjesën e vet të punës dhe të bëhet anëtar i 28-të i Bashkimit Evropian. Por, rrugën evropiane nuk e kemi parë kurrë si një garë në të cilën përparimi i një shteti vjen në kurriz të një tjetri”, ka theksuar Gorçeviq.



Shqipëria, në rast të një votimi pozitiv në referendum, do ta humbiste automatikisht vendin e dytë në listën e vendeve kryesuese, pasi Islanda do të garante me Malin e Zi, me një mundësi reale për ta tejkaluar këtë vend, duke qenë më e përgatitur për anëtarësim se çdo shtet tjetër kandidat. “Ne nuk e shohim procesin e zgjerimit si një lojë me rezultat zero, ku përparimi i një vendi përbën humbje për një vend tjetër. Përkundrazi, një rezultat pozitiv në Islandë mund të krijojë momentum të ri politik në nivel evropian për debatin mbi zgjerimin dhe të forcojë bindjen se Bashkimi Evropian mbetet projekti më i suksesshëm politik, ekonomik dhe gjeopolitik në kontinent”, kanë deklaruar për REL nga MPJ e Shqipërisë. Nga Tirana kanë theksuar se sa më i madh të jetë konsensusi politik në Evropë në favor të zgjerimit, aq më pozitiv bëhet mjedisi politik për të gjitha vendet candidate që kanë investuar seriozisht në këtë proces, përfshirë Shqipërinë.

Islanda, Mali i Zi e Shqipëria dhe disproporcioni me buxhetin e BE-së

Islanda, nga njëra anë, dhe Mali i Zi e Shqipëria, nga ana tjetër, do të kishin një raport pothuajse të kundërt me buxhetin e BE-së. Nëse Islanda do t'i bashkohej BE-së, ajo do të ishte shteti i tretë më i pasur anëtar për nga të ardhurat për kokë banori dhe do të ishte kontribuuesi neto në buxhetin e Bashkimit Evropian. Anëtarësimi i këtij shteti do të absorbohej lehtësisht nga BE-ja, pasi bëhet fjalë për një shtet të vogël për nga numri i banorëve, me pothuajse 60 për qind më pak banorë se Mali i Zi. Dallimi thelbësor mes këtyre vendeve qëndron në raportin e tyre me buxhetin evropian. Islanda, si një nga vendet më të pasura evropiane, me shumë gjasë do të ishte kontribuuesi

neto në buxhetin e BE-së, ndërsa Mali i Zi do të ishte përfituesi neto. Shumë më e varfër, por gjashtë herë më e madhe se Islanda, Shqipëria gjithashtu do të ishte përfituesi neto e fondeve të BE-së. Përfituesi neto nga buxheti i BE-së merr më shumë fonde sesa kontribuon në të, ndërsa kontribuuesi neto paguan më shumë sesa merr prej tij. Në përgjithësi, vendet më të pasura me bruto produktin shoqëror më të lartë kontribuojnë më shumë në buxhetin e BE-së, ndërsa vendet më të varfra përfitojnë më shumë. Kjo e bën Islandën një vend kandidat të pazakontë, pasi anëtarësimi i saj do të nënkuptonte zgjerimin e BE-së me një vend relativisht të pasur, dhe jo vetëm me një vend të ri që do të ishte përfitues i madh i fondeve evropiane. Pikërisht për këtë arsye, anëtarësimi i Islandës do të përbente një rast specifik në raport me zgjerimin aktual të BE-së në Ballkanin Perëndimor: ndërsa anëtarësimi i Shqipërisë dhe Malit të Zi do të përbente kryesisht një përfitim financiar për këto vende, Islanda mund të përfaqësonte një kontribut financiar për Unionin.

Pse është i rëndësishëm ky referendum për BE-në dhe rajonin?

Një rezultat pozitiv i referendomit, sipas zyrtarëve evropianë, do të përbente një nxitje për vendet aktuale candidate për anëtarësim në BE dhe do të tregonte se zgjerimi është ende i mundur. Një “po” eventuale në Islandë më 29 gusht, me shumë gjasë, do të çonte në bashkimin e këtij vendi me Malin e Zi në procesin e anëtarësimit. Shqipëria, e cila konsiderohet një nga vendet kryesuese, por nuk është në grup me Malin e Zi, do ta vazhdonte këtë proces e vetme. Nga Tirana kanë thënë se një rezultat pozitiv i referendomit në Islandë, së bashku me përparimin e vazhdueshëm të Malit të Zi drejt anëtarësimit, përbën dëshmi të qartë se procesi aktual i zgjerimit është i mirëfilltë, i besueshëm dhe i prekshëm. “Këto zhvillime nuk duhet të shihen si një diferencim mes vendeve candidate, por si një konfirmim se Bashkimi Evropian

po investon seriozisht në sigurinë, stabilitetin dhe forcën e tij të ardhshme”, kanë deklaruar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë.

Marrëdhëniet e veçanta mes Islandës dhe BE-së

Islanda në vitin 2009 paraqiti zyrtarisht kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian, pas kolapsit të rëndë të sistemit të saj bankar. Negociatat e anëtarësimit u hapën në korrik të vitit 2010. U hapën 27 kapituj negociues dhe 11 prej tyre u mbyllën përkohësisht. Qeveria e re euroskeptike e koalicionit i pezulloi negociatat në dhjetor të vitit 2013. Islanda nuk e ka tërhequr kurrë aplikimin për anëtarësim në BE, ndërsa në vitin 2015 kërkoi të mos konsiderohej më vend kandidat. Nëse qytetarët islandezë votojnë për vazhdimin e negociatave, procesi do të vazhdojë aty ku ka mbetur. Kapitujt e mbyllur nuk do të rihapen, ndërsa do të vazhdojë puna për mbylljen e kapitujve të mbetur negociues. Kjo është arsyeja pse komisionarja evropiane për Zgjerimin konsideron se, në rast të një rezultati pozitiv të referendomit, Islanda mund ta përfundojë procesin negociues me BE-në në një kohë shumë të shkurtër. “Si një vend që tashmë është pjesë e Tregut të Përbashkët evropian, Islanda mund t'i përfundojë negociatat e anëtarësimit brenda një deri në dy vjetësh”, ka vlerësuar Marta Kos më 25 gusht, në fjalimin e saj në Konferencën e Ambasadorëve, Konsujve të Përgjithshëm, Konsujve dhe atashëve ushtarakë në Zagreb. Megjithatë, edhe nëse negociatat përfundojnë në kohë rekord, anëtarësimi i plotë në BE nuk do të ndodhë brenda natës. Kjo kërkon ndryshime në Kushtetutë, në mënyrë që të mundësohet transferimi i një pjese të kompetencave sovraane. Sipas rregullave në fuqi në Islandë, ndryshimi kushtetues duhet fillimisht të miratohet në Parlament, më pas mbahen zgjedhjet e përgjithshme dhe, pas kësaj, i njëjti tekst i ndryshimit duhet të miratohet sërish nga parlamenti i ri i zgjedhur.

Kryeqyteti i Kosovës i shpall të pafajshëm Thaçin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin

PRISHTINË, 28 GUSHT - Një baner i madh me mbishkrimin “Në emër të qytetarëve të Prishtinës: Shpalleni të pafajshëm” është vendosur të premtën në qendër të kryeqytetit të

Kosovës. Baneri është vendosur në mbështetje të krerëve të Ushtisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi, të cilët po gjykohen në Hagë dhe

vendimi ndaj tyre do të shpallet më 16 shtator. Mesazhi i vendosur në qendër të Prishtinës shpreh kërkesën për pafajësinë e tyre dhe kthimin e tyre në Kosovë. Në baner, përmes thirrjes

“Shpalleni të pafajshëm”, qytetarëve u përcillet mesazhi i mbështetjes për katër krerët e UÇK-së, ndërsa kërkohet që ata të rikthehen në vend pas përfundimit të procesit gjyqësor në Hagë.



SHBA-ja DHE BE-ja NË KUVEND, PDK-ja DHE ALEANCA AKUZOJNË LV-në PËR BLOKADË: KOSOVA PO ZHYTET NË KRIZË

Deputetët e PDK-së dhe Aleancës janë kthyer sërish të premtën në sallën e Kuvendit të Kosovës, ku kanë kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, e cila, sipas tyre, po refuzohet të thirret nga Lëvizja Vetëvendosje. Aktivitetin e PDK-së dhe Aleancës në Kuvend e kanë përcjellë nga afër edhe zyrtarë të Ambasadës së ShBA-së dhe të BE-së. Dy partitë opozitare po bëjnë presion, brenda dhe jashtë Kuvendit, në mënyrë që Kosova të bëhet me institucione të reja

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 28 GUSHT - Përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe të Bashkimit Evropian (BE) kanë qenë të pranishëm të premtën në sallën e Kuvendit të Kosovës, ku deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ata të Aleancës janë mbledhur sërish pas kërkesës së radhës për vazhdimin e seancës konstituive. Edhe kësaj here, në sallë kanë munguar deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe ata të LDK-



së. Pavarësisht mungesës së këtyre deputetëve, ata të PDK-së dhe Aleancës i kanë mbajtur adresimet e tyre të zakonshme nga foltorja e Kuvendit.

Musliu kërkon vazhdimin e seancës konstituive: Kuvendi nuk është pronë e askujt

Deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, bashkë me kolegët e saj nga partia, nga sallat e Kuvendit kanë kërkuar vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, duke bërë thirrje që deputetët, pa dallim partie, të kthehen në Kuvend dhe ta përfundojnë procesin e konstituimit. Musliu ka kritikuar situatën politike në vend, duke deklaruar se Kosova është "marrë peng" nga një parti që, sipas saj, i ka vendosur ambiciet për pushtet mbi mirëqenien e qytetarëve. Ajo ka thënë se qytetarët presin

zhvillimin e politikave për një shërbim më të mirë shëndetësor, punësim për të rinjtë dhe mbështetje për prindërit, bujqit, punëtorët dhe bizneset. "Sot dua të flas për qytetarët që presin zhvillim të politikave për një shërbim më të mirë shëndetësor. Për prindërit që mezi e dalin muajin. Për të rinjtë që kërkon një vend pune me meritokraci. Për bujqin, për punëtorin, për biznesmenin që lufton çdo ditë për ta mbajtur biznesin gjallë dhe me të drejtë pyesin: Çfarë po ndodh me vendin tonë? Dhe përgjigjja është e thjeshtë dhe shumë e qartë. Kosova është

marrë peng dhe kjo është për turp. Kosova është marrë peng nga një parti e cila erdhi në pushtet me fjalë të mëdha. Kosova është marrë peng nga një parti e cila arriti që shpresën e qytetarëve për një jetë të mirëqenë ta keqpërdorë për ambiciet e veta për pushtet. Kosova është marrë peng nga një parti e cila veç mirëqenien e Kosovës nuk e ka në agjendën e saj. Dhe kjo parti e ka lënë vendin sot pa institucione. Kjo parti po luan me besimin tuaj, qytetarë të dashur, dhe po luan me durimin e një populli që ka duruar më shumë se ç'duhet. Por çdo durim e ka edhe një fund. Kosova nuk mund të presë më. Nuk mund të presë që politikanë të papërgjegjshëm të qëndrojnë mbi ligj e Kushtetutë, ndërkohë që jeta e qytetarëve po shënon regres në çdo ditë dhe në çdo sferë", ka thënë ajo. Sipas saj, Lëvizja Vetëvendosje po tregon haptazi se e ardhmja e popullit dhe e shtetit të



Kosovës nuk është më prioritet për të. "Partia e cila i fitoi zgjedhjet e kaluara po tregon haptazi se e ardhmja e popullit dhe e shtetit të Kosovës nuk është më prioritet për të. Kjo situatë është e papranueshme dhe e patolerueshme, sepse politika nuk guxon të shërbejë për të ushqyer ambicie personale. Politika duhet të vihet në shërbim të qytetarit dhe interesave shtetërore dhe kombëtare. Prandaj sot, apeli im për të gjithë ata që kanë marrë mandat nga qytetarët, pa dallim partie, është: ejani në Kuvend. Ejani ta konstituojmë Kuvendin e ta fillojmë punën. Kuvendi nuk është pronë e askujt. Kuvendi është i Kosovës dhe i qytetarëve të saj. Në këtë Kuvend është vota e prindërve që ëndërrojnë për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Është vota e pensionistit që shpreson se angazhimi ynë do të koncentrohet në zhvillimin e politikave përkatëse. Është vota e mërgimtarit që ëndërron rritjen e standardit të atdheut të tij. Është vota e punëtorit, e mësuesit, e mjekut, e infermierit, e studentëve, zjarrfikësit, e bujqit, e fermerit e biznesmenit. Në këtë Kuvend është edhe vota e ushtarit dhe e policit që e veshin uniformën çdo mëngjes dhe janë të

gatshëm të sakrifikojnë jetën për sigurinë tonë dhe të vendit tonë", ka thënë Musliu.

Tahiri: Moskonstituimi i Kuvendit e ka sjellë Kosovën në depresion të thellë shoqëror, ekonomik dhe politik

Ndërsa deputeti i Aleancës, Besnik Tahiri, ka kritikuar shumicën parlamentare për moskonstituimin e Kuvendit, duke deklaruar se kjo situatë e ka futur Kosovën në një krizë të thellë shoqërore, ekonomike dhe politike. Tahiri ka deklaruar se gjendja në vend po përkeqësohet dhe po shkon drejt një pike kritike, duke e ndërlidhur situatën edhe me aspektin e sigurisë dhe ekonomisë. Sipas tij, kjo qasje është e qëllimshme dhe ka për synim ta çojë Kosovën drejt një "krize identitare". "Tanimë kjo shumicë parlamentare, e cila sot e ka ditë është duke bojkotuar dhe duke mos ushtruar detyrën e vet kushtetuese, me moskonstituimin e Kuvendit e ka sjellë Kosovën në një depresion të thellë shoqëror, ekonomik dhe politik. Gjendja në vend është ka agravon dhe

është ka vjen në një pikë kritike që ndërlidhet edhe me aspektin e sigurisë në shoqëri, edhe me aspektin e ekonomisë që krijon vende pune dhe që e mban gjallë shtetin, dhe mbi të gjitha, një krizë politike e cila nuk ka qenë e parë asnjëherë në historinë e demokracisë të vendit tonë. Kjo është e qëllimshme", ka thënë Tahiri, duke shtuar se kjo qasje nga Vetëvendosje ka vetëm një qëllim. "Dhe qëllimi është ta sjellë shtetin e Kosovës në një krizë identitare të cilën historikisht e ka luftuar. Ky konstelacion politik ka qenë në anën e kundërt të historisë në kohën e Marrëveshjes së Rambujesë dhe në kohën kur NATO ka hyrë në Kosovë. Ky konstelacion politik ka qenë në anën e kundërt, në të kundërtën e historisë kur është shpallur pavarësia e Kosovës. Ky konstelacion politik sot është duke u munduar ta ndërtojë një tregim, një tregim i cili është tregim i rremë, është tregim kundër çdo përpjekjeje historike të kombit shqiptar në Kosovë, të krijimit të një identiteti tjetër. Këtë nuk do ta lejojmë. Këtë nuk do t'ia mundësojmë. Ne nuk kemi vend tjetër, as shtet tjetër dhe as arritje më të madhe kombëtare se pavarësinë e



A BARTIN PËRGJEGJËSI PENALE QEVERTARËT NË DETYRË PËR MBAJTJEN E DY FUNKSIONEVE?

PRISHTINË, 28 GUSHT - Me gjithë aktgjykimin e vitit 2025 të Gjykatës Supreme të Kosovës se ushtrimi i dy funksioneve është i kundërligjshëm, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, prej javësh është edhe deputet. Ngjashëm, ministra në detyrë janë aktualisht edhe anëtarë të legjislaturës së 11-të të Kuvendit të Kosovës.

Teksa Qeveria në detyrë e Kosovës është përballur me kritika për gjoja tejkalim kompetencash për shkak të disa vendimeve të fundit, janë ngritur pikëpyetje edhe nëse pjesëtarët e saj duhet të bartin përgjegjësi penale për veprimet e tyre.

Derisa deri më tani ata nuk janë prekur, kallëzimet e reja penale, të dorëzuara nga kundërshtarët e tyre politikë këtë javë, dhe aktgjykimi i gjykatës më të lartë në sistemin e rregullt ligjor të vendit kanë krijuar kushte për hetimin e tyre, sipas ekspertëve ligjorë me të cilët bisedoi “Radio Evropa e Lirë”.

Çfarë baze kanë prokurorët për t’i ndjekur ata penalisht?

Dorëzimi i kallëzimit penal në Prokurorinë Speciale ndaj pjesëtarëve të Qeverisë në detyrë s’është diçka e re. Një gjë e tillë ndodhi edhe në marsin e vitit 2026. Dhe, deri më tani, asgjë s’ka ngjarë pas kallëzimit nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Tash, Partia

Demokratike e Kosovës dhe Aleanca kanë bërë kallëzime të ndara penale ndaj ministrave në detyrë dhe vendimeve të tyre.

Ekspertë ligjorë kanë thënë për “Radion Evropa e Lirë” se kryeministri dhe ministrat në detyrë “me dashje” po marrin vendime që mund të përbëjnë vepër penale e për të cilat duhet të bartin përgjegjësi, duke qenë të vetëdijshëm se Kushtetuta e Kosovës dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme ua ndalojnë ushtrimin e funksioneve të dyfishta dhe se Ligji për Qeverinë ua kufizon kompetencat.

Sipas tyre, prokurorët duhet të provojnë se, përmes vendimeve që marrin, duke ushtruar dy funksione, qeveritarët në detyrë po e shkelin detyrën zyrtare.

Avokati Ardian Bajraktari ka thënë se qëllimi është element “esencial dhe i rëndësishëm” për prokurorët për ta nisur një hetim penal ndaj tyre. “Pas aktgjykimit të Supremes, vazhdimi i funksionit të këtyre dy detyrave, marrja e vendimeve, dhe për rrjedhojë fakti se vendimet kanë ndikim, për mua përmushet elementi i qëllimit, i cili është element vendimtar i kategorisë së veprave penale që ndërlidhen me keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe korrupsionit”, ka thënë Bajraktari për “Radion Evropa e Lirë”.

Gjykata Supreme e rrëzoi më 2025 një udhëzim administrativ të ministrit në detyrë të



Financave, Hekuran Murati, duke gjykuar se ai ishte i paligjshëm, sepse Murati po ushtronte dy funksione - të deputetit dhe të ministrit. Sipas nenit 71 të Kushtetutës, ushtrimi i funksioneve të deputetit dhe të ministrit në të njëjtën kohë është i ndaluar.

Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Ehat Miftaraj, ka argumentuar për Radion “Evropa e Lirë” se mbajtja e pozitës së kryeministrit dhe ministrave, nga persona të cilët janë betuar si deputetë, nuk përmush elementet e veprës penale të moszbatimit të vendimeve gjyqësore.

Megjithatë, sipas tij, mbajtja e pozitës së kryeministrit dhe ministrave në detyrë, nga individë të betuar si deputetë, i përmush “të gjitha elementet e figurës së veprës penale” të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414.1 të Kodit Penal të Kosovës. Miftaraj ka shtuar se kryeministri dhe ministrat në

detyrë, me vendimet e kohëve të fundit, kanë keqpërdorur detyrën dhe kanë shkelur kompetencat, duke “i sjellë përfitime vetes dhe personave të tjerë, disa nga të cilët publikisht [njihen si] persona të afërt me partinë, si dhe kanë dëmtuar persona të tjerë përmes veprimeve kundërligjore”.

Bajraktari e ka mbështetur argumentin e Miftarajt, duke theksuar se në Kodin Penal mund të ketë elemente përmes të cilave konstatohet shpërdorimi i detyrës zyrtare.

Ai ka besuar se Prokuroria do të nisë hetime për këtë rast. Kodi Penal parasheh dënim me burgim prej një deri në tetë vjet për një zyrtar që i tejkalon kompetencat e tij.

Prokuroria Speciale nuk iu përgjigj pyetjes së “Radios Evropa e Lirë” nëse po i shqyrton kallëzimet penale dhe nëse do të nisë hetim penal ndaj kryeministrit dhe ministrave në detyrë.

As Qeveria në detyrë nuk iu

përgjigj pyetjes së “REL” -it lidhur me kallëzimet penale ndaj saj dhe pyetjes nëse anëtarët e saj po i tejkalojnë kompetencat.

Por, ajo është arsyetuar më herët se nuk mund ta ndalojë punën për shkak të tranzicionit politik.

Çfarë vendimesh mori Qeveria në detyrë dhe cilat janë përgjegjësitë e saj?

Ligji për Qeverinë përcakton se një qeveri në detyrë ka kompetenca të kufizuara. Në mënyrë të qartë ndalohej marrja e vendimeve të rëndësishme. Sipas këtij ligji, një qeveri në detyrë mund t’i zbatojë vetëm aktivitetet e domosdoshme, të planifikuara në planin vjetor dhe në Ligjin për Buxhetin. Në javët e fundit, Qeveria Kurti - në detyrë që nga shpërbërja e legjislaturës së dhjetë të Kuvendit, muaj më parë - ka marrë vendime për emërimin e individëve në pozita të larta drejtuese edhe pas zgjedhjeve. Ajo ka emëruar një komision të pranimit për pozitën e sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe në atë të Ministrisë së Shëndetësisë. Po ashtu, ka ngritur komisione të ngjashme edhe për poste të tjera, përfshirë atë të drejtorit ekzekutiv për Thesarin e Kosovës. Përveç emërimeve, Qeveria në detyrë ka marrë edhe vendime që prekin pronën publike, duke ndarë tokë dhe parcela për shfrytëzim.

Kosovës. Kjo pavarësi është arritja më e madhe e kombit shqiptar. Për këtë tanimë ka sakrifikuar gjeneratë pas gjenerate, e kemi obligim me qenë këtu në vendin e punës tonë dhe me mbrojtur arritjen tonë më të madhe kombëtare”, ka thënë Tahiri.

PDK-ja dhe Aleanca vazhdojnë protestën para Qeverisë: Bllokada e institucioneve po dëmton edhe komunat

Deputetë të PDK-së dhe përfaqësues të Aleancës kanë kërkuar nga kryeministri në detyrë, Albin Kurti, që të kthehet në Kuvend dhe të mundësojë vazhdimin e procesit të konstituimit të institucioneve, duke vlerësuar se bllokada po shkakton pasojë edhe për komunat e Kosovës. Këto deklarata janë bërë gjatë protestës së grupit parlamentar të PDK-së para ndërtesës së Qeverisë, së cilës i janë bashkuar edhe asamblistë dhe aktivistë nga Komuna e Ferizajt dhe Hani i Elezit. Pjesëmarrësit kanë kërkuar funksionalizimin e institucioneve qendrore dhe sqarimin e situatës juridike që, sipas tyre, po ndikon edhe në raportet ndërmjet nivelit

qendror dhe atij lokal.

Deputeti i PDK-së, Elmi Reçica, duke iu referuar një aktgjykimi të Gjykatës Supreme, ka deklaruar se Kurti duhet të zgjedhë mes mandatit të deputetit dhe funksionit në Qeveri. “Aktgjykim të Gjykatës Supreme thuhet qartë. Kryeministër dhe deputet nuk mund të jesh. Duhet të zgjedhësh. Deputet dhe ministër nuk mund të jesh. Duhet të zgjedhësh. Prandaj i bëj ftesë deputetit Albin Kurti, gjegjësisht vandalit politik, që t’i ndalë këto vandalizma. Të kthehet në Parlament, nëse i ka 61 vota ta zgjedhë Qeverinë, për t’ia votuar kryetarin dhe nënkryetarin e Kuvendit do t’ia votojmë ne, ja bëjmë votat edhe ne edhe Aleanca, dhe të fillojë së funksionuari ky shtet. Përndryshe, në këto kushte, në këto rrethana, në këto momente, kur Kosova pret. Kur Kosova pret ata të cilët e kanë krijuar këtë realitet. Kur e kanë shpallur pavarësinë e këtij vendi. Kur e kanë bërë këtë vend shumë të rëndësishëm për të gjithë ne. Ai krijon kriza. Sepse duke krijuar kriza, ai menaxhon situata për të keqen e vendit. Prandaj i bëj ftesë, le të kthehet në Kuvend. Sepse mund të bëhet vonë për këtë vend dhe për të gjithë të cilët janë pengesë për ecjen përpara

të këtij vendi”, ka thënë ai.

Ndërsa kryetari i Aleancës në Ferizaj, Alberton Sahiti, ka deklaruar se komunat po përballen me probleme si pasojë, sipas tij, të mosfunksionimit dhe mungesës së përkrahjes nga niveli qendror. “Ju e dini të gjithë se me çfarë probleme, me cilat sfida po përballen sot komunat e Kosovës, e sidomos Komuna e Ferizajt, që mendoj që është njëra prej komunave që është prekur më së shumti nga mosprojektet dhe mosrealizimet dhe mosfunksionimi i mirëfilltë i kësaj, apo mospërkrahja e kësaj qeverie. Kurrë më shumë se sot nuk i bëjmë thirrje këtij personi, këtij individ, që të thërrasë seancat, të mos bllokojë vetëm institucionet qeverisëse, mirëpo të mos bllokojë edhe komunat. Jemi në një prag, jo të mirë, jemi në një gjendje të jashtëzakonshme, edhe komunat edhe komplet Kosova, nuk mendoj që ne i kemi borxh gjithë atyre njerëzve që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për këtë vend, për këto institucione”, ka thënë Sahiti.

Kurse shefi i grupit të asamblistëve të PDK-së në Ferizaj, Arian Imeri, ka deklaruar se protesta është



edhe në emër të përfaqësuesve komunalë dhe pjesëtarëve të ekzekutivit lokal nga regionin e Ferizajt. “Jam këtu para Qeverisë së Republikës së Kosovës që të shpreh në shenjë proteste për moskonstituimin e institucioneve dhe mosfunksionalizimin e tyre. Këtë qëndrim e shpreh edhe në emër të anëtarëve të kuvendeve komunale dhe pjesëtarëve nga ekzekutivi i komunave që vijnë nga regionin e Ferizajt. Moskonstituimi i institucioneve qendrore nuk është një krizë politike e radhës në Prishtinë, po është një goditje e drejtpërdrejtë ndaj çdo komune, ndaj çdo familje dhe ndaj çdo lagjeje në komunat nga vijnë. Prandaj,

kjo, do të kërkojmë që të bëhet një zgjidhje sa më shpejt sa i përket formimit të institucioneve. Njëherë, shkakton një pasiguri juridike sa i përket komunikimit në mes të institucioneve qendrore dhe institucioneve lokale, prandaj kërkojmë nga organet e drejtësisë që sa më shpejt ta sqarojnë këtë situatë. Raportet në mes të institucioneve komunale dhe institucioneve qendrore kërkojnë institucione funksionale, kërkojnë vendimmarrje të ligjshme, me idenë që vendimet, proceset të cilat fillojnë tani, të mos kontestohen nesër, sepse pasojat pastaj juridike, financiare po i bartin qytetarët tanë”, ka thënë Sahiti.

Hyseni: Patriarkati po i shndërron burrat në kriminelë dhe po vret gra cep më cep të Kosovës

PRISHTINË, 28 GUSHT - Me moton "Vrasja e grave të trajtohet si urgjencë kombëtare", Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist ka protestuar të premten në Prishtinë kundër vrasjeve dhe dhunës ndaj grave. Qendresa Hyseni, në emër të organizatës, kritikoi ashpër patriarkatin dhe institucionet e Kosovës, duke thënë se gratë po jetojnë në një gjendje të vazhdueshme pasigurie dhe se dhuna ndaj

tyre nuk duhet të trajtohet si raste të izoluar familjare. Ajo i ka cilësuar dy vrasjet e grave të ndodhura gjatë kësaj jave si episode të femicidit, duke argumentuar se ato lidhen me një sistem patriarkal që, sipas saj, prodhon dhe toleron dhunën ndaj grave. Hyseni ka thënë se dhuna shfaqet në forma të ndryshme, përfshirë dhunën ekonomike, psikologjike, seksuale dhe fizike, ndërsa theksoi se edhe

rastet e dhunës seksuale ndaj burrave burojnë, sipas saj, nga e njëjta logjikë e pushtetit patriarkal. Ajo ka kritikuar institucionet për mosmarrjen, sipas saj, të masave të mjaftueshme për mbrojtjen e grave dhe kërkoi që siguria dhe jeta e tyre të trajtohen si çështje me urgjencë kombëtare. "Jemi çu me e denoncu këtë sistem i cili dhunon e vret, e i cili na kërcënon prej shpise e deri në



KRYEPROKURORI I SHTETIT KËRKON RAPORT PËR RASTIN E VRASJES SË TREFISHTË NË GLLOGJAN

PRISHTINË, 28 GUSHT - Kryeprokurori i Shtetit ka kërkuar raport me shkrim nga kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore në Pejë lidhur me veprimet e ndërmarra nga kjo prokurori në rastin e vrasjes së trefishtë në fshatin Gllogjan. "Në bazë të kompetencave të tij ligjore, Kryeprokurori i Shtetit ka kërkuar nga Kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore në Pejë raport me shkrim lidhur me kronologjinë e veprimeve të ndërmarra nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë

për rastin e vrasjes së trefishtë në fshatin Gllogjan, pasi që Gjykata Themelore në Pejë, më datë 24 gusht 2026, ka marrë aktgjykim lirues ndaj personave të akuzuar për këtë rast", ka njoftuar Kryeprokurori i Shtetit. Gjykata Themelore në Pejë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj tre të akuzuarve, Kastriot, Kreshnik dhe Halil Mehmetaj, lidhur me akuzën për vrasjen e trefishtë më 26 nëntor 2021 në Gllogjan, ku kishin mbetur të vdekur dy nxënës dhe shoferi i



autobusit. Kurse, për armëmbajtje pa leje, Halil Mehmetaj u dënua me 3 vjet burgim, ndërsa Kreshnik Mehmetaj me 1 vit burgim. Të tre persona, babai me dy të

bijtë, Halil, Kastriot dhe Kreshnik Mehmetaj akuzoheshin se, më 26 nëntor 2021, nën motivin e hakmarrjes, kanë shtënë me kallashnikov në drejtim të një autobusi në Gllogjan, ku kanë mbetur të vrarë dy nxënës 17-vjeçarë dhe shoferi i autobusit. Kastriot dhe Kreshnik Mehmetaj është liruar nga akuza për veprën penale "Vrasje e rëndë" në bashkëkryerje, kurse Halil Mehmetaj është liruar nga akuza për veprën penale "Shtytje në vrasje të

rëndë". Kastriot Mehmetaj është liruar nga akuza edhe për armëmbajtje pa leje. Kurse, Halil dhe Kreshnik Mehmetaj janë shpallur fajtorë për armëmbajtje pa leje. I pandehuri Halil Mehmetaj për këtë vepër është dënua me 3 vjet burgim, kurse i pandehuri Kreshnik Mehmetaj është dënua me 1 vit burgim. Aktgjykimi është shpallur të hënën njëzëri nga trupi gjyqësor i kryesuar nga kryetari Leon Përlaska dhe anëtarët Shaqë Curri dhe Arben Mustafaj.

KONJUFCA SHPALLET I PAFAJSHËM PËR HEDHJEN E GAZIT LOTSJELLËS NË KUVEND

PRISHTINË, 28 GUSHT - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur të pafajshëm ministrin në detyrë të Punëve të Jashtme, Glauk Konjufcën, i cili akuzohej për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës. Gjykatësja Edita Çanta, gjatë shpalljes së aktgjykimit, ka deklaruar se Konjufca lirohet nga akuza. "I pandehuri Glauk Konjufca lirohet nga akuza", ka deklaruar ajo.

Konjufca akuzohej për veprën penale "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm", lidhur me hedhjen e gazit lotsjellës gjatë një mbledhjeje në sallën e Kuvendit të Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë, më 26 shkurt 2024, kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj Konjufcës, me arsyetimin se nuk ishte provuar se kishte



kryer veprën penale "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm". Ndërsa, për veprën penale "Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare", për të cilën

kishte arritur parashkrimi, akuza ishte refuzuar. Megjithatë, Gjykata e Apelit e kishte rrëzuar vendimin e Themelores dhe e kishte kthyer rastin në rigjykim. Ndryshe, në

seancën e 25 tetorit 2023, gjykatësja Edita Çanta kishte bërë të ditur se Konjufcës i ishte parashkuar vepra penale "Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare". Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 3 shkurt 2017, kishte ngritur aktakuzë ndaj Glauk Konjufcës, duke e ngarkuar me dy vepra penale. Sipas aktakuzës, Konjufca, më 10 gusht 2016, gjatë mbajtjes së një mbledhjeje në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në cilësinë e deputetit, kishte hedhur gaz lotsjellës në sallë. Në aktakuzë thuhet se, si pasojë e gazit lotsjellës, pjesëmarrësit ishin detyruar ta braktisnin sallën, pasi qëndrimi i tyre ishte pamundësuar nga tymi i shkaktuar nga gazi. Konjufca akuzohej për veprën

penale "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm", nga neni 375, paragrafi 1 i Kodit Penal, e cila parashihet dënim me burgim prej një deri në tetë vjet. Ndërsa, me dispozitivin e dytë të aktakuzës, ai akuzohej se gjatë përdorimit të gazit lotsjellës kishte penguar personat zyrtarë, përfshirë kryetarin e atëhershëm të Kuvendit, Kadri Veselin, dhe deputetët Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Sabri Hamiti, Pal Lekaj, Valdete Bajrami dhe Sllibodan Petroviq, në kryerjen e detyrave zyrtare. Për këtë vepër, Konjufca akuzohej për "Pengimin e personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare", sipas nenit 409, paragrafi 1 të Kodit Penal, e cila dënohej me burgim prej tre muajsh deri në tre vjet.

Haxhiu kritikon vonesën e katalogut të teksteve: Prindërit janë vënë nën presion

PRISHTINË, 28 GUSHT - Deputetja e Aleancës, Teuta Haxhiu, ka kritikuar Ministrinë e Arsimit për vonesën në miratimin e katalogut të teksteve shkollore, duke theksuar se procedurat janë përfunduar vetëm më 27 gusht, pak ditë para fillimit të vitit të ri shkollor. Haxhiu ka deklaruar se vonesa ka krijuar presion te prindërit, ndërsa ka kritikuar ministrinë për menaxhimin e procesit dhe mungesën e përgjigjeve ndaj problemeve të raportuara përmes platformës "eKosova".

Ajo ka ngritur shqetësime edhe për prindërit me lejeqëndrim në Kosovë, të cilët, sipas saj, nuk kanë mundur të aplikojnë për subvencionimin e teksteve. Haxhiu ka kritikuar gjithashtu shumën e subvencionimit, duke prezantuar fatura që, sipas saj, tregojnë se kostoja e teksteve në disa raste është më e lartë se shumata e ndarë nga shteti. Ajo ka kërkuar përgjegjësi për vonesat dhe zgjidhje për problemet që kanë hasur prindërit gjatë procesit të subvencionimit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka miratuar katalogun e teksteve shkollore dhe ka ekzekutuar mjetet në llogaritë e prindërve përfitues për subvencionimin e teksteve shkollore për nxënësit e klasave 1-9 për vitin shkollor 2026/2027. Vlera e subvencionimit për prind/nxënësit për tekstet shkollore në gjuhën shqipe sipas klasave është si në vijim: klasat 1 dhe 2 - 60 euro, klasa 3 - 65 euro, klasa 4 - 70 euro, klasa 5 - 80 euro, klasat 6 dhe 7 - 90 euro, klasat 8 dhe 9 - 100 euro.



Maqedonci dhe zyrtarja e NATO-s diskutojnë për sigurinë në rajon

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur në takim Blanca Hereza Atienza, udhëheqëse e Sektorit të Operacioneve Aktuale në Divizionin e Operacioneve të NATO-s, së bashku me delegacionin e saj. Gjatë takimit janë diskutuar zhvillimet e sigurisë në rajon, situata aktuale dhe rëndësia e koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve të

Kosovës dhe NATO-s. Maqedonci ka vlerësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me NATO-n, si dhe kontributin e Aleancës në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe stabil në Kosovë dhe rajon. Ai ka theksuar se Kosova mbetet e përkushtuar për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me NATO-n dhe për të kontribuar, sipas kapaciteteve të saj, në sigurinë dhe stabilitetin rajonal e ndërkombëtar.

“Vlerësova bashkëpunimin e vazhdueshëm me NATO-n dhe kontributin e Aleancës për ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe stabil në Kosovë dhe rajon. Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me NATO-n dhe për të kontribuar, me kapacitetet tona, në sigurinë dhe stabilitetin rajonal e ndërkombëtar”, ka theksuar Maqedonci.



PALATOVA LARGOHET NGA KOSOVA, U BËN APEL AKTORËVE POLITIKË TË ANGAZHohen ME BE-në PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ushtruesja e detyrës së Shefes së Bashkimit Evropian në Kosovë, Eva Palatova, po largohet nga Kosova pas më shumë se tre vitesh angazhim. Ajo ka shërbyer si ushtruese e detyrës së shefes së BE-së në Kosovë që nga prilli 2026. Në mesazhin e saj të fundit, Palatova u ka bërë apel autoriteteve dhe aktorëve politikë në Kosovë që të angazhohen me Bashkimin Evropian në mënyrë konstruktive, bashkëpunuese dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve. “Ndërsa ushtruesja e detyrës së Shefes së BE-së në Kosovë,

Eva Palatova, largohet pas më shumë se tre vitesh të përmbushura në Kosovë, gjatë të cilave marrëdhëniet BE-Kosovë hyjnë në një kapitull të ri, apeli i saj i fundit për autoritetet dhe aktorët politikë të Kosovës është që të angazhohen me BE-në në mënyrë konstruktive, bashkëpunuese dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve”, është thënë në mesazhin e publikuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Ajo ka vlerësuar se gjatë periudhës së angazhimit të saj, marrëdhëniet mes Kosovës dhe BE-së kanë hyrë në një kapitull të ri.



PAS KATËR VITESH NË KOSOVË, AMBASADORI FRANCEZ PËRFUNDON MISIONIN DIPLOMATIK



PRISHTINË, 28 GUSHT - Pas katër vitesh shërbimi në Kosovë, ambasadori i Francës, Olivier Guerot, ka përfunduar misionin e tij diplomatik në vend. Lajmi është bërë me dije nga Ambasada e Francës në Kosovë, e cila ka vlerësuar se mandati i Guerot u karakterizua nga forcimi i lidhjeve dhe miqësisë ndërmjet Francës dhe Kosovës. Në një mesazh të publikuar në rrjetet sociale, Ambasada e Francës ka falënderuar ambasadorin Guerot për përkushtimin dhe kontributin e tij gjatë katër viteve të shërbimit në Kosovë. “Pas katër vitesh në Kosovë, ambasadori i Francës, Olivier Guerot,

përfundon misionin e tij diplomatik, një mandat i cili u karakterizua me forcimin e lidhjeve dhe miqësisë ndërmjet Francës dhe Kosovës”, është thënë në mesazhin e ambasadës. Ambasada franceze i ka uruar Guerot sukses në angazhimet e tij të ardhshme, duke shprehur mirënjohje për punën dhe kontributin e tij gjatë mandatit në Kosovë. “Faleminderit, zoti ambasador, për përkushtimin dhe kontributin tuaj gjatë këtyre katër viteve. Ju urojmë shumë suksese në angazhimet tuaja të ardhshme!”, është thënë në fund të mesazhit.

Kadetët e FSK-së përfaqësojnë Kosovën në Akademinë Ushtarake në Gjermani

DRESDEN, 28 GUSHT - Një delegacion i kadetëve nga Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka marrë pjesë në Javën Ndërkombëtare të Kadetëve, e cila është mbajtur në Akademinë Ushtarake në Dresden të Gjermanisë. Sipas njoftimit të Forcës së

Sigurisë së Kosovës, pjesëmarrja në këtë aktivitet është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe forcimit të marrëdhënieve ushtarake ndërkombëtare. Aktiviteti ka mbledhur së bashku udhëheqës të ardhshëm ushtarakë nga shtete të ndryshme aleate, duke u ofruar kadetëve

mundësinë për shkëmbim të përvojave dhe njohje me metodat bashkëkohore të trajnimit, doktrinës dhe udhëheqjes ushtarake. Po ashtu, vizita ka shërbyer për forcimin e diplomacisë mbrojtëse dhe ndërtimin e urave të bashkëpunimit e besimit me partnerët ndërkombëtarë.



ATK-ja dhe Posta e Kosovës diskutojnë thellimin e bashkëpunimit dhe digjitalizimin e shërbimeve

PRISHTINË, 28 GUSHT - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Mentor Hyseni, ka pritur në takim kryeshefen ekzekutive të Postës së Kosovës Nora Rraci, me të cilën ka diskutuar mundësitë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy

institucioneve. Takimi është fokusuar në mundësitë konkrete për koordinim më të mirë, shkëmbim të përvojave dhe krijimin e proceseve më efikase, veçanërisht në funksion të shërbimeve që prekin drejtpërdrejt qytetarët dhe bizneset. “U diskutuan

gjithashtu hapësirat ku ekspertiza dhe kapacitetet e dy institucioneve mund të plotësojnë njëra-tjetrën, duke përfshirë edhe përdorimin më të mirë të zgjidhjeve digjitale dhe mundësitë për lehtësimin e proceseve administrative”, ka njoftuar ATK-ja.

**QUMËSHTORET KËRKOJNË RIKTHIMIN E PRODHIMIT, PARALAJMËROJNË NDËRPRERJEN E GRUMBULLIMIT NGA 1 SHTATORI**

PRISHTINË, 28 GUSHT – Përfaqësuesit e Shoqatës së Industrisë së Qumështit të Kosovës kanë dorëzuar të premten kërkesat e tyre në Ministrinë e Bujqësisë, duke kërkuar takim me ministrin në detyrë, Armend Muja. Aata kanë kërkuar rikthimin e menjëhershëm të prodhimit të produkteve të qumështit. Po ashtu, ata kanë kërkuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) që ta lëshojë një komunikatë zyrtare përmes së cilës do të konfirmohet siguria e produkteve të industrisë vendore për konsumatorët. Një tjetër kërkesë është anulimi i vendimit të datës 15 maj 2026, me numër 1414, të nxjerrë nga ministri në detyrë Armend Muja. Po ashtu, qumështoret kërkojnë nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të ndërmarrë masa konkrete për adresimin e çmimeve që Shoqata i konsideron dumping në tregun e produkteve të qumështit. Kryetari i Shoqatës së Industrisë së Qumështit të Kosovës, Gani Durmishaj, ka deklaruar se kërkesat janë dorëzuar edhe zyrtarisht me shkrim. Ai ka kërkuar që prodhuesve t’u mundësohet menjëherë rifillimi i punës dhe prodhimit të produkteve të qumështit. “Po, kërkesat i kemi dhënë edhe me

shkrim. Kërkojmë kthimin e menjëhershëm të punës për prodhuesit, për prodhimin e produkteve të cilat na i kanë ndërprerë”, ka deklaruar Durmishaj. Ai ka kërkuar gjithashtu që AUV-i të dalë me një komunikatë zyrtare për qytetarët, duke konfirmuar nëse produktet e prodhuara nga industria vendore janë të sigurta për konsum. Shoqata ka kërkuar edhe anulimin e vendimit të 15 majit 2026, si dhe ndërhyrjen e institucioneve për trajtimin e çmimeve të produkteve të qumështit në treg. Durmishaj ka paralajmëruar se, nëse kërkesat nuk plotësohen dhe institucionet nuk ndërmarrin masa konkrete, nga 1 shtatori 2026 qumështoret do të ndërpresin grumbullimin e qumështit nga fermerët. “Në rast se kërkesat tona nuk plotësohen dhe nuk ndërmerren masa konkrete nga institucionet kompetente, nga 1.9.2026 do të ndërpritet grumbullimi i qumështit prej qumështoreve tona. Domethënë, nuk do të marrim qumësht nga asnjë pikë grumbulluese, as nga fermerët, deri në vendimin tjetër që e nxjerr ministri”, ka thënë ai. Sipas Durmishajt, një situatë e tillë mund të shkaktojë pasoja të mëdha për sektorin e



qumështit dhe mijëra fermerë që furnizojnë qumështoret vendore. Ai ka paralajmëruar se moszgjidhja e situatës mund të çojë në një krizë të madhe për sektorin. “Unë mendoj që kjo do të bëhet një skandal bukur i madh, me keqardhje po them. Nuk është vendim i yni. Ne disa herë e kemi potencuar që mund të përpunojmë jo veç me qumështin e Kosovës, por edhe me importuar qumësht të freskët. Problemi është që vendimi të cilin e ka marrë Ministria na e ka ndërprerë prodhimin në qumështoret e Kosovës”, ka deklaruar Durmishaj. Ai ka thënë se vendimi prek të gjitha qumështoret anëtare të Shoqatës së Industrisë së Qumështit të Kosovës dhe mund të ndikojë në rreth 20 mijë fermerë. “Afër 20 mijë fermerë janë

nëpër këto qumështore. Kjo nuk është për disa qumështore, por është vendim për të gjitha qumështoret të cilat janë anëtare të Shoqatës së Industrisë së Qumështit të Kosovës”, ka theksuar ai. Durmishaj ka kritikuar edhe mënyrën se si, sipas tij, është trajtuar çështja nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ai ka kërkuar që AUV të publikojë rezultatet e analizave të kryera në produktet e qumështoreve vendore. Sipas tij, rezultatet e analizave që u janë kthyer qumështoreve nuk kanë evidentuar ndonjë problem që do t’i bënte produktet të rrezikshme për konsum. “Ata kanë bërë një skandal të jashtëzakonshëm. Ne nuk po kërkojmë që ata veç me thënë. Në bazë të analizave të cilat i ka bërë AUV-i dhe na ka kthyer ne për qumështoret, nuk ka gjetur diçka që është e dëmshme, qysh kanë publikuar këtë për opinionin, për konsumatorin”, ka thënë Durmishaj. Ai ka kërkuar nga AUV-i që të publikojë rezultatet dhe të dëshmojë gjetjet e analizave të kryera. Durmishaj ka kundërshtuar gjithashtu ndërprerjen e prodhimit për shkak të shkeljeve eventuale të rregullave për deklarimin e përbërjes apo pre-jardhjes së produkteve. Sipas tij, në raste të tilla duhet të ketë mundësi për korrigjim dhe

afat ligjor për përmbytjen e kërkesave, në vend të ndërprerjes së menjëhershme të prodhimit. “Për një gabim apo për një lëshim që nuk ka qenë vendimi më përpara që të shkruhet pre-jardhja bimorë apo vaj palme, asnjë ligj kur bëhet nuk vjen vendim që me ua ndërprerë prodhimin. Mund të korrigjohen. Nëse ka bërë ndonjë lëshim ndonjë prej qumështoreve, mund të korrigjohet, mund t’i jepet afat ligjor. Por nuk mundet me ndërprerë marrjen”, ka deklaruar ai. Durmishaj ka thënë se situata ka shkaktuar dëme për prodhuesit vendorë edhe në aspektin e shitjeve, pasi konsumatorët, sipas tij, janë hezitantë të blejnë produktet vendore pas raportimeve dhe deklarimeve lidhur me sigurinë e tyre. “Neve na ka bërë dëm të madh, se tash konsumatorët na ka ndaluar shitja. Që prej muajit shkurt na ka ndaluar shitja, po hezitojnë njerëzit me i marrë produktet vendore prej shkakut të opinionëve të cilat janë pothuajse skandal”, ka thënë Durmishaj. Shoqata e Industrisë së Qumështit kërkon që institucionet të reagojnë sa më shpejt për të zgjidhur situatën, në të kundërtën paralajmëron ndërprerjen e grumbullimit të qumështit nga fermerët duke filluar nga 1 shtatori.

DOGANA ZBULON MBI 54 MIJË EURO TË PADEKLARUARA NË KULLË

PRISHTINË, 28 GUSHT - Dogana e Kosovës ka zbuluar mbi 54 mijë euro mjete monetare të padeklaruara gjatë kontrollit të një automjeti në pikën kufitare me Malin e Zi (Kullë). Sipas njoftimit të doganës, automjeti ishte përzgjedhur për kontroll të detajuar në vijën e dytë, ku zyrtarët

doganorë kanë gjetur para të gatshme në euro dhe valuta të huaja. “Pas konvertimit të shumës sipas kursit zyrtar, vlera totale e mjeteve monetare të padeklaruara ka rezultuar mbi 54 mijë euro”, ka njoftuar dogana. Në përputhje me procedurat ligjore, është konfiskuar 25



për qind e shumës së padekluar, në vlerë prej mbi 13 mijë e 500 eurosh, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve është proceduar sipas dispozitave në fuqi. Dogana e Kosovës ka rikujtuar udhëtarët se janë të obliguar t’i deklarojnë mjetet monetare gjatë kalimit të kufirit, në

përputhje me legjislacionin në fuqi. “Dogana e Kosovës mbetet e përkushtuar në parandalimin dhe luftimin e veprimtarive të kundërligjshme, duke siguruar njëkohësisht zbatimin e drejtë dhe të barabartë të procedurave ligjore”, ka njoftuar dogana.

Pacolli paralajmëron gjoba për kompanitë që vonojnë projektin e banimit social në Podujevë

PODUJEVË, 28 GUSHT - Ministria në detyrë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Fitore Pacolli, ka shprehur shqetësim për vonesat në realizimin e Projektit të Banimit të

Përballueshëm dhe Social në Podujevë. Gjatë vizitës në vendpunishte, Pacolli ka zhvilluar takim me përgjegjësin e kompanisë që po kryen punimet, duke kërkuar respektimin e afateve

të përcaktuara me kontratë. Ajo ka deklaruar se kompanitë që nuk i përmbushin obligimet kontraktuale do të përballen me gjoba. “Projektet duhet të realizohen brenda afateve të përcaktuara me

kontratë. Për kompanitë që nuk i përmbushin obligimet dhe afatet do të shqiptohen gjoba. Do të jemi të pakompromis me kompanitë e papërgjegjshme”, ka thënë Pacolli.



TENSIONE NË SPANJË - CEUTA NË PRAG LUFTE, BANORËT BLOKOJNË USHQIMET PËR EMIGRANTËT DHE I VËNË FLAKËN KAMPIT



Protestuesit shkatërruan dhe u vunë flakën strukturave të një kampi të improvizuar, ndërsa policia spanjolle ndërhyri për të shpërndarë turmën...

Kriza e migracionit në Ceuta është përshkallëzuar në përlëshje mes banorëve dhe migrantëve, pasi një grup protestuesish shkatërroi dhe u vuri flakën strukturave të një kampi të improvizuar në një prej plazheve të qytetit autonom spanjoll. Trazirat ndodhën në plazhet Trampolín dhe Benítez, ku iu vu flaka çadrave prej kashte dhe disa sendeve personale të migrantëve. Protestuesit formuan gjithashtu një zinxhir njerëzor për të bllokuar kalimin e kamionëve të Kryqit të Kuq, të cilët transportonin ushqime të destinuara për refugjatët.

Situata detyroi Policinë Kombëtare Spanjolle të ndërhynte për të shpërndarë protestën, përmes ndërhyrjes së forcave policore dhe përdorimit

të plumbave të gomës.

Pse nisën protestat në Ceuta?

Protestat shpërthyen mes pakënaqësisë në rritje të një pjese të popullsisë lokale për shkak të pranisë së mijëra migrantëve, të cilët prej disa javësh qëndrojnë në rrugë dhe plazhe.

Protestat u organizuan kryesisht përmes grupeve të banorëve në WhatsApp dhe Telegram dhe u përshkallëzuan me shpejtësi.

Ndër kërkesat kryesore të protestuesve janë identifikimi i migrantëve, transferimi i tyre në qendrat e pritjes dhe kthimi i atyre që nuk kanë autorizim për të qëndruar në territorin spanjoll.

Gjatë tubimeve u dëgjuan slogane të tilla si: "Ceuta nuk është në shitje, Ceuta mbrohet" dhe "Pushues, dëbim".

Duhet theksuar se dita e protestave u parapri nga përlëshje

të tjera. Tensionet u përshkallëzuan pasi, sipas autoriteteve, një grup migrantësh hodhi gurë në drejtim të një automjeti ushtarak, duke plagosur katër ushtarë spanjollë. Incidenti shtoi pakënaqësinë mes disa shtresave të popullsisë dhe u pasua nga trazira në zonat ku ndodhen kampet e improvizuara.

Çfarë po ndodh me migracionin në Ceuta?

Qyteti autonom, i vendosur në Afrikën e Veriut dhe në kufi me Marokun, po përballët me një presion të lartë migrator, i cili ka çuar në limit kapacitetet e tij për akomodim dhe ofrimin e ndihmës humanitare.

Një nga problemet kryesore është mbërritja e personave që përpiqen të hyjnë në Ceuta nga deti, duke anashkaluar barrierat kufitare dhe duke ndërmarrë udhëtime që mund të zgjasin me

orë të tëra.

Rritja e numrit të mbërritjeve ua ka vështirësuar autoritetet dhe organizatat humanitare sigurimin e strehimit dhe shërbimeve bazë për të gjithë personat që kanë mbetur në qytet.

CETI, i mbingarkuar nga mbërritja e migrantëve

Qendra e Qëndrimit të Përkohshëm të Imigrantëve (CETI) në Ceuta ndodhet nën presion të madh për shkak të rritjes së numrit të personave që kërkojnë strehim.

Mbipopullimi i ambienteve ka detyruar disa prej migrantëve të qëndrojnë përkohësisht në hapësira publike, përfshirë plazhet, ndërsa autoritetet po kërkojnë alternativa për strehimin dhe kujdesin ndaj tyre.

Organizatrat humanitare kanë shtuar shpërndarjen e ushqimeve, ujit dhe furnizimeve

të tjera, megjithëse qasja në disa prej kampeve të improvizuara është kthyer gjithashtu në një burim tensioni.

Rrjetet sociale, një tjetër faktor në krizë

Mbërritja masive e migrantëve është shoqëruar edhe me një qarkullim intensiv informacioni në rrjetet sociale.

Autoritetet spanjolle kanë hetuar mesazhe dhe përmbajtje të shpërndara në platformat digjitale, të cilat mund të kenë kontribuar në mobilizimin e njerëzve drejt kufirit përmes pretendimeve dhe thashethemeve mbi lehtësinë e supozuar të hyrjes në territorin spanjoll.

Kjo situatë i ka shtuar edhe elementin e dezinformimit një krize që ndërthur tashmë faktorë migratorë, humanitarë, politikë dhe të sigurisë.

Trump ndryshon planet për 11 shtatorin, nuk pritet të shkojë në vendin ku ndodheshin Kullat Binjake

Presidenti amerikan Donald Trump nuk pritet të marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore në "Ground Zero" më 11 shtator, në 25-vjetorin e sulmeve terroriste ndaj Kullave Binjake.

Sipas "New York Post", Trump planifikon ta përkujtojë këtë përvjetor në Pentagon, i cili ishte një nga objektivat e sulmeve të 11 shtatorit 2001. Sipas një burimi të informuar, presidenti nuk e ka në axhendë pjesëmarrjen në ceremoninë që zhvillohet çdo vit në

Manhattan, në vendin ku dikur qëndronin kullat e World Trade Center.

Megjithatë, deri më 14 gusht ishte parashikuar që Trump të merrte pjesë në ceremoninë e Ground Zero, ndërsa arsyeja e ndryshimit të planit nuk është bërë e qartë.

Një nga arsyet e raportuara mund të jetë fakti se organizatorët e ceremonisë nuk lejojnë politikanët të mbajnë fjalime në Ground Zero, rregull i vendosur që prej vitit 2012. Në ceremoninë e



këtij viti pritet të marrë pjesë në vend të Trump zëvendës-presidenti amerikan

JD Vance.

Përvjetori i 25-të i sulmeve, ku humbën jetën 2.977 persona,

zhvillohet një ditë pas përfundimit të konventës dyditore të Partisë Republikane në Dallas, ku Trump pritet të marrë pjesë në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet e nëntorit.

Pas ceremonisë në SHBA, Trump pritet të udhëtojë drejt Irlandës më 12 dhe 13 shtator, ku do të takohet me punonjës të ambasadës amerikane dhe drejtues biznesesh, si dhe do të ndjekë turneun Irish Open në fushën e tij të golfit në Doonbeg.

“MASKILIZËM ME RRAHJE GJOKSI”: TAPICERIA E BAJOSË ZBULON TË VËRTETËN E PËRGJAKSHME DHE TË PAHIJSHME PËR MESJETËN

Në rrëfimin e kryeveprës së shekullit XI për një fron të kontestuar, e cila së shpejti do të ekspozohet në Mbretërinë e Bashkuar, burrëria barazohet me pushtetin - dhe me shtojcën më të madhe e më krenare. Ajo rrëfen një histori që duket e njohur sot.

Nga: Deborah NICHOLLS-LEE / BBC

Tapiceria e Bajosë [Bayeux Tapestry] rrëfen një histori të përgjakshme - dhe herë pas here të pahijshme - të pushtimit norman të Anglisë. Kryevepra e ndërlukuar është qëndisur në 70 metra pëlhurë liri dhe thur një rrëfim për thyerjen e premtimeve, lakminë dhe agresionin, që kulmon me vdekjen e Mbretit Harold II në Betejën e Hejstingsit.

Pas pothuajse një mijë vjetësh, vepra ikonike e artit po kthehet nga Normandia e Francës në Angli, ku u qëndis me mjeshtëri në vitet 1070 dhe, nga ky shtator, do të ekspozohet në Muzeun Britanik. Është një vepër arti që paraqet një version mesjetar të manosferës së sotme digjitale: një ideologji dhe botë e përqendruar te hipermaskuliniteti dhe përvojat e burrave. Dhe, një botë ku madhësia ka rëndësi.

Kontributet e burrave janë në qendër të shoqërisë së shekullit XI që tapiceria paraqet. Një e treta e burrave në të janë të armatosur, ndërsa të tjerët janë të angazhuar fuqishëm në prerjen e pemëve, ndërtimin e anijeve dhe në ndërtime. Një druvar, ulur me këmbë të hapura mbi një trung të gjatë, bën gati sëpatën, ndërsa gjuetarët tundin shkopinjë e mëdhenj mbi kokë teksa ndjekin prenë e tyre. E gjithë kjo ndihmon në përcjelljen e atmosferës së tensionuar të një ballafaqimi të afërt mes dy meshkujve alfa: Uiliamit, Dukës së Normandisë, dhe Haroldit II. “Është e vështirë të gesh një skenë më të mbushur me testosteron”, komenton Dr. Christopher Monk, historian i kulturës së Anglisë mesjetare.

Kjo shfaqje sugjeshive e maskilizmit me rrahje gjoksi zbulon një shoqëri mesjetare të krijuar për burrat dhe nga burrat, ku dhuna zgjidh mosmarrëveshjet dhe humori prej çunash shërben për të fituar pikë politike. Plackitës të armatosur bëjnë kërdrinë nëpër Hejstings, ndërsa ushtarët e rënë në skajin e poshtëm zhvishen

lakuriq për t’ua marrë armaturën, ashtu siç Haroldi, i vrarë sipër tyre, zhvishet nga pretendimi i tij për fronin.

Penisi si motiv i përsëritur

Nëse ka një motiv që përsëritet në këtë vepër ikonike arti, ai është penisi. Në vitin 2018, George Garnett, profesor i historisë mesjetare në Universitetin e Oksfordit në Mbretërinë e Bashkuar, numëroi 93 të tillë - shumica të erektuar - në qëndisje. Tetëdhjetë e tetë u përkisnin kuajve dhe pesë të tjerë burrave, ndërsa një këllëf shpate i varur (të cilin ai e përjashton) ka shkaktuar debat të konsiderueshëm në qarqet akademike.

“Madhësia ka rëndësi në Tapicerinë e Bajosë”, vëren Janina Ramirez në Femina: Një histori e re e Mesjetës, përmes grave të fshira prej saj [Femina: A New History of the Middle Ages, Through the Women Written Out of It, 2022]. Në rrëfimin e tapicerisë për një fron të kontestuar, burrëria barazohet me pushtetin dhe, siç vëren ajo, shtojca më e madhe dhe më krenare “i përket hamshorit të bukur që i paraqitet Uiliamit në prag të betejës”. Vendin e dytë e zë kali i Mbretit Harold, “duke nënkuptuar se ai është një kundërshtar i denjë”.

Brenda traditave të artit të shekullit XI, lakuriqësia grafike ishte e zakonshme dhe është kreu i mundur që këta penisë të jenë qëndisur nga murgeshat. “Ato pasqyrojnë atë që ishte kaq e dukshme në shoqërinë elitare mesjetare - në përgjithësi, burrat ishin shtytësi kryesorë të sovranitetit politik”, i thotë Monku BBC-së. “Përdorimi i organeve gjenitale mashkullore, qoftë të njeriut apo të kuajve”, thotë ai, është “një mënyrë e shkurtër për të shprehur maskilizmin politik në kontekstin e kalimit drejt botës së re anglo-normane në Anglinë mesjetare”.

Nëse gratë luajnë një rol të vogël në tapiceri, kjo ndodh kryesisht sepse “rrëfimi sillet rreth



Një detaj që paraqet ushtarë mbi kuaj nga Tapiceria e Bajosë [Bayeux Tapestry] (Foto: Alamy)

veprimeve të burrave”, i thotë BBC-së, Dr. Emily Joan Ward, ligjëruese e historisë mesjetare në Universitetin e Edinburgut në Mbretërinë e Bashkuar. “Në pjesën më të madhe, paraqiten burra të angazhuar në veprimtari ushtarake dhe, në ato skena beteje, nuk do të prisnim të shihnim gra”. Nëse një raport prej një me 100 ende duket i pabarabartë, një shpjegim mund të gjendet te publiku për të cilin ishte menduar vepra. Historianët besojnë se porositësi i mundshëm i tapicerisë ishte gjysmëvëllai i Uiliamit, peshkopi Odo i Bajosë, i cili zë një vend të rëndësishëm në të dhe mund ta ketë përdorur tapicerinë për të theksuar rolin e tij të rëndësishëm në fushatën për sundimin e ligjshëm të Uiliamit. “Përmbajtja ndoshta synon të ketë jehonë tek ai dhe rrethi i tij i ngushtë shoqëror, i cili në pjesën më të madhe do të ketë qenë një rreth homosocial burrash”, thotë Wardi. Me një porositës norman, mesazhi duhej të ishte në përputhje me të. “Futja e shumë grave në rrëfim është në fakt disi e rrezikshme”, shton ajo. “Përpjekjet e Uiliamit për të theksuar legjitimitetin e tij për fronin përmes linjës femërore mund ta kenë bërë krijuesin ose porositësin të druhej se mos tërhiqte vëmendjen te ky pretendim i brishtë”.

Gjashtë gratë në tapiceri

Gratë në rrëfimin qendror shërbejnë kryesisht si ajo që Monku e quan “pikësim emocional”. Mbretëresha Edit, një figurë me shumë ndikim në politikën e oborrit, fshin lotët me shaminë e saj ndërsa bashkëshorti i saj, Eduard Rrëfyti, merr frymë e fundit; ndërsa një grua dhe femija i saj ikin teksa ushtarë gjigantë normanë, pa e vrarë mendjen, i vënë zjarrin shtëpisë së tyre. Duke lënë mënjatë shprehjet dhe përmasat e çuditshme, është një skenë që na kujton, thotë Ward, “se lufta nuk është vetëm një ngjarje e dominuar nga burrat,

nuk është vetëm ajo që ndodh në fushëbetejë”.

Ajo i referohet historianes Catherine Karkov, e cila vëren se gratë në regjistrin kryesor shfaqen në ato çaste kur ndryshojnë raportet e pushtetit. “Nëse e interpretojmë në këtë mënyrë”, vëren Wardi, “kjo u jep atyre një rol mjaft të fuqishëm në tapiceri”. Bordurat dekorative sipër dhe poshtë tapicerisë na çojnë në një botë që është më subversive për shkak të kritikës së saj të koduar ndaj personazheve qendrore, shpesh në formën e fabulave. Pikërisht këtu shfaqen tri nga gratë.

Në bordurën e poshtme, një grua zmbropset nga një agresor seksual, për të cilin mendohet se është babai i saj. Më vonë, në bordurën e sipërme, dy gra të zhveshura që bëjnë geste drejt burrave lakuriq mendohet se lidhen me rrëfimet për një joshëse dhe një prostitutë të cilat përdorën trupat e tyre për të mashtruar, duke aluduar për betimin e thyer të Haroldit.

Na mungon vajza e Uiliamit, Agata e Normandisë, e cila iu ofrua Haroldit si pjesë e shkëmbimit për kurorën. Wardi vëren se na paraqitet anija mbresëlënëse kryesore e Uiliamit, anija më e madhe dhe më e shpejtë e flotës normane, e quajtur Mora, por nuk e shohim gruan e tij të fuqishme, Matildën e Flandrës, e cila pagoi për anijen për të ndihmuar në arritjen e suksesit ushtarak që do ta bënte atë mbretëreshë.

“Momenti mesjetar Me Too”

Megjithatë, një figurë misterioze e mbështjellë me mantel përmendet me emër: Aelfgiva. Një prift në dukje grabitqar, me një pelerinë të gjelbër, zgjat dorën drejt fytyrës së saj, ndërsa në kornizë, një burrë lakuriq me organe gjenitale jashtëzakonisht të mëdha imiton pozën e tij. Propozimet se kush është ajo dhe pse ndodhet aty janë të shumta. Ka kuptim sugjerimi i Dr. David Musgrove, bashkautor i Rrëfimi

prapa tapicerisë së Bajosë [The Story of the Bayeux Tapestry, 2026], se ngacmimi seksual nga prifti po denoncohet në “një moment mesjetar Me Too”.

Të tjerët kanë qenë më shpërfillës. Siç komentoi një historian i shekullit XX: “Meqenëse nuk i shton asgjë rrëfimit, përveç një çasti pëshqjellimi, e kemi konsideruar të arsyeshme ta lëmë jashtë”.

Ashtu siç murgjit futnin ilustrime në marginat e dorëshkrimeve, është e mundur që qëndistareve t’u jetë lejuar njëfarë lirie krijuese me këto komente enigmatike për rrëfimin qendror. “Pa dyshim që ato punonin sipas një skice”, i thotë Monku BBC-së. “Por, kjo nuk do të thotë patjetër se ato ishin thjesht zbatuese të vullnetit të dikujt tjetër, apo se çdo hollësi ishte e diktuar”.

Ndoshta, në bordurë, gratë e padukshme pas kësaj veprë e thanë fjalën e fundit. “A ishte kjo një mënyrë për të shprehur dëshpërimin ndaj burrave luftarakë apo ndaj gjendjes së tyre si gra të nënshtruara angleze? A ka ndonjë element talljeje, veçanërisht me Uiliamin? Apo po kënaqeshin me një humor lozonjar e të shpenguar për të kaluar kohën”? - pyet Monku.

“Ndoshta është e pamundur t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve, por së paku ato duhet të na bëjnë të reflektojmë për faktin se Tapiceria e Bajosë ekziston vetëm falë punës së shkathët dhe inteligjente të grave”.


Tapiceria origjinale ka ardhur në Angli pas një mijë vjetësh dhe do të ekspozohet nga shtatori në Londër

(Foto: Getty Images)

Ishte ndjeshmëria viktoriane ajo që, në fund, do ta zbuste një pjesë të maskilizmit të tapicerisë origjinale. Në një kopje besnike, të krijuar në vitin 1885 nga një grup prej 35 grash që i përkisnin Shoqatës Lik të Qëndisjes (aktualisht e ekspozuar në Muzeun e Redingut), ushtritë që përparojnë janë ende plot me burra, por organet e stërmëdha të kuajve janë tërhequr. Siç mund të pritej, burri lakuriq me organet jashtëzakonisht të mëdha gjenitale, i cili imitonte priftin në bordurë, në versionin e ri paraqitet i veshur me pantallona të shkurtra. Por, më e rëndësishmja, duke shtuar një bordurë tjetër ku secila qëndistare qëndisi emrin e saj, versioni i vitit 1885 nderoi krijueset dhe pohoi praninë e grave. Siç vëren Ramirez: “Ndërsa askujt nuk do t’i shkonte ndër mend të diskutonte për Natën me yje pa përmendur Van Goghun... shumë pak veta i fillojnë diskutimet për Tapicerinë e Bajosë duke menduar për gratë që e krijuan atë”. /Telegrafi/



Në Tapicerinë e Bajosë, kali i mashkullit alfa Uiliam pasqyron burrërinë e pronarit të tij(Foto: Alamy)



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ademi dhe presidentët e federatave evropiane diskutojnë për të ardhmen e futbollit

MONAKO, 28 GUSHT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka marrë pjesë në aktivitetet e UEFA-s në Monako, ku është hedhur shorti për fazën e ligës

së UEFA Champions League. Ademi ka bërë me dije se në këtë aktivitet ka qenë së bashku me zëvendëspresidentin e UEFA-s, Armand Duka, si dhe me

drejtues e personalitete të tjera të futbollit evropian. "Po ashtu mora pjesë edhe në takimin e presidentëve të federatave evropiane dhe përfaqësuesve të UEFA-s, ku diskutuam për të

ardhmen e qeverisjes së futbollit botëror, forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe respektimin e parimeve institucionale", ka shkruar Ademi.



DONJETA SADIKU E ARTË NË LOJËRAT MESDHETARE

TARANTO, 28 GUSHT - Donjeta Sadiku i ka sjellë Kosovës medaljen e parë në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026", dhe ajo është e artë. Boksierja e Kosovës ka triumfuar në finalen e kategorisë deri në 60 kilogramë, ku është përballur me garuesen që ka përfaqësuar Serbinë, Kristina Kuluhova. Meçi është ndërpërprerë në raundin e dytë pasi Kuluhova ka pësuar lëndim në arkadë. Arbitrat i kanë numëruar pikët deri në momentin e ndërprerjes dhe Sadiku është shpallur fituese me rezultatin 4:0. Katër

gjiqtarë e kanë vlerësuar Sadikun fituese në të dy raundet, ndërsa njëri e kishte vlerësuar duelin të barabartë deri në ndërprerje. Sadiku gjatë turneut në Taranto ka regjistruar tri fitore, duke e kurorëzuar paraqitjen e saj me medaljen e artë. Triumfi merr edhe një dimension të veçantë për shkak të kundërshtares, e cila ka garuar nën flamurin e Serbisë, shtet që vazhdon të kundërshtojë pjesëmarrjen e sportistëve të Kosovës në ngjarjet ndërkombëtare.

Në ring, Sadiku ishte bindëse dhe deri në momentin e ndërprerjes ka kontrolluar duelin me goditje të sakta dhe avantazh të qartë. Ndërkohë, Kristina Kuluhova nuk është paraqitur në ceremoninë e podiumit për ta pranuar medaljen e argjendtë. Në podium janë ngjitur Donjeta Sadiku dhe dy fitueset e medaljeve të bronzta. Për këtë fitore të madhe, Donjeta Sadiku ka marrë urime të shumta nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, partiake dhe sportive.



DRITA ELIMINOHET NGA LIGA E KONFERENCËS PAS DRAMËS SË PENALLTIVE

ESCALDES-ENGORDANY, 28 GUSHT - Drita është eliminuar nga UEFA Conference League, pasi në ndeshjen e kthimit të fazës së "play-off"-it është mposhtur nga Inter D'Escaldes pas ekzekutimit të penalltive. Pas barazimit 2:2 në ndeshjen e parë të zhvilluar në Prishtinë, skuadrat nuk kanë arritur të gjenin rrugën drejt golit në Andorrë. Koha e rregullt dhe dy vazhdimet nga 15 minuta kanë përfunduar 0:0, duke bërë që fituesi të përcaktohej nga pika e bardhë. Në serinë e penalltive, Inter D'Escaldes ka triumfuar 4:2. Për Dritën kanë shënuar Besnik Krasniqi dhe Raddy Ovouka, ndërsa Kristal Abazaj dhe Igbal Jashari nuk kanë arritur t'i konkretizojnë dy penalltitë e fundit. Te skuadra



vendëse ishin të saktë Lamine Diaby, Juan Camara, Maurizio Pochettino dhe Faysal Chouaib. Portieri i Dritës, Faton Maloku, ka arritur ta ndalte penalltinë e Borja Arellanos, por kjo pritje nuk ka mjaftuar që skuadra gjilanasë ta vazhdonte rrugëtimin evropian. Maloku ishte ndër lojtarët më të dalluar të Dritës

gjatë kësaj ndeshjeje. Ai ka regjistruar disa pritje të rëndësishme dhe, së bashku me repartin defensiv, ka arritur ta mbante portën e paprekur gjatë 120 minutave. Kësisoj, Drita nuk ka arritur ta përsërisë suksesin e edicionit të kaluar në garat evropiane, duke e mbyllur aventurën e saj në Conference League në fazën e "play-off"-it.

Ballkani rikthen Sami Sermaxhaj në krye të skuadrës

Suharekë, 28 gusht - FC Ballkani ka njoftuar rikthimin e Sami Sermaxhaj në postin e trajnerit, pak kohë pasi klubi ka konfirmuar largimin e teknikut Mislav Karoglan. Sermaxhaj rikthehet te skuadra nga Suhareka pas disa vitesh, ndërsa ai nuk është emër i panjohur për klubin. Trajneri e ka drejtuar Ballkanin edhe më herët, gjatë periudhës shtator 2018 - maj 2019. Në njoftimin e klubit është thënë se Sermaxhaj është "njeriu i shtëpisë" dhe se rikthehet në një moment të rëndësishëm për Ballkanin. "Sermaxhaj e njeh shumë mirë Ballkanin dhe rrugëtimin e tij, pasi ka qenë në



krye të ekipit edhe gjatë periudhës nga shtatori i vitit 2018 deri në maj të vitit 2019", është thënë në komunikatën e klubit. Ballkani ka theksuar se përvoja dhe njohja e trajnerit me klubin pritet të ndihmojnë skuadrën në sfidat e ardhshme dhe në përmbyshjen e objektivave të sezonit. Sami Sermaxhaj tashmë do të ketë detyrën ta rikthejë stabilitetin në skuadër pas largimit të Karoglanit.

Ndeshje të jashtëzakonshme në Ligën e Kampionëve

MONAKO, 28 GUSHT - Top-ndeshje do të zhvillohen në fazën e Ligës së Kampionëve. Shorti për fazën e ligës, që është faza kryesore dhe zëvendëson atë grimore, është tërhequr në Monako. Në fazën e ligës do të paraqiten 36 skuadrat më të mira evropiane. Secila prej tyre i luan nga tetë ndeshje në fazën e ligës. Për short, skuadrat ishin

të ndara në katër vazo të ndryshme. Dhe secili ekip ka nga dy kundërshtarë prej secilës vazo. Fituesi në fuqi i Ligës së Kampionëve, PSG-j do të luajë në shtëpi me Barcelonën dhe në udhëtim me Manchester City. Kundërshtarë tjerë të Parisit janë Roma, Aston Villa, Galatasaray, Villarreali, Slovan Bratislava dhe Como. Ndërsa

kampioni i Gjermanisë, Bayerni do të luajë me Arsenalin, Atletico Madridin, Real Betisin, Manchester Unitedin, Bodo/Glimtin, Lillen, Slavia Pragën dhe Vikingun. Kurse Real Madridi do të luajë kundër Interit, Arsenalit, PSV-së, Romës, Leipzigut, Shakhtarit, LASK-ut dhe AEK-ut. Kundërshtarë të Barcelonës janë

Manchester City, Parisi, Aston Villa, Sportingu, Feyenoordi, Galatasaray, Como dhe Sabahu. Pos me Real Madridin dhe Bayernin, Arsenali do të luajë me Dortmundin, Real Betisin, Lillen, Napolin, Sabahun dhe Slavia Pragën. Ndeshjet e para të fazës së ligës janë më 8 shtator. Pas tetë xhirove avancojnë plot 24 skuadra. Tetë të parat në



tabelë shkojnë direkt në një të tetën e finales. Ndërkohë skuadrat prej vendit të nëntë deri në vendin e 24-t avancojnë nga faza e ligës në "play-off"-in e fazës nokaut.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “J&N Construction” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 812221456 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “J&N Construction” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nr. 812221456 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “J&N Construction” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812221456 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshepte

RESTAURANT**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Njoftim për rritje kapitali
nga 'HAK BAU' Sh.PK**

“Hak Bau” Sh.PK me seli në Gjakovë, bënë rritjen e kapitalit të SH.PK-së me numër unik identifikues NUI: 812452382, të leshuar nga ARBK.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frashi” Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi” Prizren.
- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të leshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastian Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

